

**KONTRATË DHURIMI PJESËSH
TË KAPITALIT THEMELTAR TË SHOQËRISË TREGTARE**

“TREAL CONSTRUCTION” sh.p.k

Në Tiranë, sot më datë 11.03.2022 palët pjesëmarrëse në kontratë:

PALA DHURUESE

Erjon Mehmeti, atësia Bajazit, amësia Ermira, shtetas Shqiptar, lindur në Sarandë, banues në Tiranë, me adresë: Rr. “Bilal Xhaferri”; Nd. 6; H. 3; Ap. 3; “Njësia Administrative” Nr. 5; “Njësia Bashkiake” Nr. 5; nr. 1019, lindur më 29/07/1979, gjendja civile “i martuar”, , i regjistruar me nr. personal **H90729155C**.

PALA PRANUESE E DHURIMIT

Erjola Mehmeti, atësia Emin, amësia Sanije, shtetase Shqiptare, lindur në Sarandë, banues në Tiranë, me adresë: Rr. “Bilal Xhaferri”; Nd. 6; H. 3; Ap. 3; “Njësia Administrative” Nr. 5; Nr. 1019, lindur më 15/05/1984, gjendja civile “e martuar”, regjistruar me nr. personal **I45515076C**.

Shtetasit e paraqitur janë madhorë, me zotësi të plotë juridike dhe zotësi të plotë juridike për të vepruar, të cilët me vullnet të lirë, të plotë e të pavesuar hartojne kontrate dhurimi si më poshtë vijon:

NENI 1

BAZA LIGJORE

Kontrata e dhurimit bazohet në nenin 761 e vijues të Kodit Civil; Ligjit “Për noterinë” si edhe të Ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” dhe të Ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

NENI 2

PËRMBAJTJA E KONTRATËS

Pala dhuruese, **Erjon Mehmeti**, është ortak i vetëm në shoqërinë “**TREAL CONSTRUCTION**” **sh.p.k**, e themeluar dhe që ushtron aktivitetin e saj sipas legjislacionit shqiptar, themeluar më datë 09/05/2013, me NUIS **L31713002D**, me seli në Tiranë, Rruga “Peze Helmes”, ZK 2953, nr.pasurie 11/24, vol. 9, fq. 115.

Pala dhuruese, ortak i vetëm **Erjon Mehmeti**, është zotërues i 1.00 (një) pjese të kapitalit themeltar të shoqërisë, me pjesëmarrje në përqindje 100 % (njëqind përqind) të pjesës së kapitalit themeltar e barabartë me 10.000.000,00 lekë (dhjetë milion lekë).

Kapitali themeltar i shoqërisë është 10.000.000,00 (dhjetë milion) lekë.

NENI 3

OBJEKTI I KONTRATËS

Pala dhuruese **Erjon Mehmeti** dëshiron t’i dhurojë palës pranuese të dhurimit motrës së tij **Erjola Mehmeti**, 100 % pjesë të kapitalit themeltar me vlerë 10.000.000,00 lekë, pra të gjithë atë që ai zotëron në kapitalin e shoqërisë, duke u larguar vetë si ortak i shoqërisë “**TREAL CONSTRUCTION**” **sh.p.k**.

Erjola Mehmeti, me pranimin nga pala dhuruese të 100 % të pjesës së kapitalit bëhet ortak e vetme e shoqërisë “**TREAL CONSTRUCTION**” **sh.p.k**.

NENI 4

TRANSFERIMI KAPITALIT

- 1 E drejta e pronësisë mbi kuotat e palës dhuruese, i kalon palës pranuese të dhurimit në momentin e nënshkrimit të kontratës.
- 2 Pala dhuruese i dorëzon palës pranuese të dhurimit të gjitha dokumentat, deklaratat, ose certifikatat e nevojshme për përfundimin e transferimit të kuotave të kapitalit themeltar në favor të palës pranuese të dhurimit dhe për regjistrimin e këtij transferimi pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.
- 3 Në momentin e transferimit të kuotave pala pranuese e dhurimit **Erjola Mehmeti** bëhet zotëruese e 100 % të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë, kurse pala dhuruese **Erjon Mehmeti**, largohet si ortak i shoqërisë.

NENI 5

DEKLARATA DHE GARANCI

Pala dhuruese deklaron dhe garanton palën pranuese të dhurimit për sa më poshtë vijon:

- 1 Pala dhuruese është pronare e ligjshme e kuotave që i dhuron nga palës pranuese të dhurimit, të cilat janë të nënshkruara dhe të paguara plotësisht;
- 2 Shoqëria ka dorëzuar të gjitha deklaratimet e raportimet e tatimeve që kërkohen të dorëzohen sipas ligjit dhe ka paguar të gjitha vlerësimet tatimore, tarifat dhe detyrime të tjera shtetërore për Shoqërinë, pasurinë e të ardhurat e saj, që sipas ligjit janë të detyrueshme për t'u paguar;
- 3 Shoqëria nuk është në shkelje të ndonjë marrëveshjeje me të cilën është palë;
- 4 Shoqëria nuk është palë, as nuk është në dijeni të ndonjë rreziku për ndjekje gjyqësore, arbitrazhi, apo administrative, rezultati i së cilës mund të kishte efekt material negativ për dhurimin e kuotave të kapitalit themeltar.

NENI 6

DETYRIMET TATIMORE DHE NDAJ TË TRETËVE

Pala pranuese e dhurimit pranon të përfitojë 100 % të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë, si më sipër, me gjendjen e aktivitetit të bilancit të shoqërisë, deri në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate. Dhuruesi deklaron se shoqëria nuk ka detyrime financiare ndaj shtetit dhe të tretëve dhe se në rast të kundërt, nëse ka detyrime deri në datën e sotme të nënshkrimit të kontratës, pala dhuruese i merr përsipër t'i likujdojë ato dhe janë vetëm në ngarkim të saj dhe në asnjë rast në ngarkim të ortakes (**Erjola Mehmeti**).

NENI 7

KUSHTE TË PËRGJITHSHME

Kjo kontratë do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis palëve në lidhje me këtë kontratë, ose çdo marrëveshje tjetër, ose dokument të zbatuar midis palëve për zbatimin e kësaj kontrate do të zgjidhet me mirëkuptim midis palëve, në rast të kundërt nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Kjo Kontratë përbën marrëveshjen e plotë midis palëve, në lidhje me çështjet që trajton dhe zëvendëson çdo marrëveshje të mëparshme, qoftë me gojë apo me shkrim, midis palëve.

Pavlefshmëria ose pabazueshmëria e njëres nga dispozitat e kësaj kontrate nuk do të çënojë vlefshmërinë ose zbatueshmërinë e dispozitave të tjera.

Dispozita e pavlefshme do te zevendesohet me nje marreveshje ligjerisht te vlefshme, qe korrespondon sa shume te jete e mundur me synimet e paleve.

NENI 8

NJOFTIMET

Te gjitha njoftimet dhe komunikimet mes paleve do te behen me shkrim dhe do te konsiderohen si te dhena menyre te rregullt nese i dorezohen ne dore, i dergohen me poste te regjistruar ose me faks pales ne adres paracaktuar nga palet.

NENI 9

DISPOZITA E FUNDIT

8.1 Ne baze te ligjit nr. 9887, date 10.03.2008 "Per mbrojtjen e te Dhenave Personale", i ndryshuar, perpuno te dhenat personale te subjekteve te ketij akti ne menyre te drejte dhe te ligjshme.

8.2 Kontrata hartohet ne gjuhen shqipe ne 3 (tre) origjinale, me vlere te njejte ligjore e perbere nga 3 (tre) secila.

PALET KONTRAKTUESE

PALA DHURUESE

Erjon Mehmeti



PALA PRANUESE E DHURIMIT

Erjola

Mehmeti

